



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2017

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Lënda: Filozofi

Udhëzime të përgjithshme

- Testi përmban në total 40 pikë.
- Testi ka 20 pyetje: 10 me zgjedhje dhe 10 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigjja e saktë vlerësohet me një pikë.
- Për pyetjet me zhvillim janë dhënë modele përgjigjesh të sakta.

- **Pyetjet me zgjedhje**

Numri i Pyetjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigja e saktë	A	A	B	C	A	A	A	D	C	B

- **Pyetjet me zhvillim**

Shënim:

- Në skemën e vlerësimit të testit, për pyetjet me zhvillim janë dhënë modele përgjigjesh të sakta. Nxënësi do të marrë pikët e merituar edhe nëse ai ka dhënë përgjigje me fjalë të tjera por që janë brenda kontekstit të përgjigjes së saktë.
- Në pyetjet me zhvillim, ku kërkohen dy, tre apo katër nga të gjitha përgjigjet e sakta të mundshme, në rast se nxënësi ka dhënë aq përgjigje të sakta sa i kërkohen nga pyetja, atëherë atij do t'i jepen të gjitha pikët maksimale me të cilat është vlerësuar pyetja.
- Nxënësi do të marrë aq pikë sa është vlerësuar pyetja edhe në rast se ai ka dhënë më shumë përgjigje të sakta nga sa i kërkohen.
- Nxënësi merr pikë duke dhënë përgjigje sipas formimit të tij edhe nga lëndët e tjera. Kalimi nga njëra pikë te tjetra e një problemi nuk e ndëshkon në pikëzim, pasi ato lidhen me njëri-tjetrin

Pyetja 11

4 pikë

Njohja e vërtetë është njohja racionale që arrihet përmes shpirtit, mendjes, jo përmes shqisave. Pra njohje e vërtetë nuk është ajo shqisore. Shqisat japin njohuri sipërfaqësore, të përkohshme, jo të plota, jo të sakta.

Për të njohur duhet të arrijmë te idetë. Ato janë realitete të dallueshme, të ndara nga veprimi. Për Platonin idetë kanë ekzistencë të pavarur nga bota jonë e sendeve/dukurive konkrete. Idetë nuk janë krijim i shpirtit tonë. Ato janë realitete të përjetshme, të pandryshueshme, që ekzistojnë para çdo gjëje/janë shkak nga kanë rrjedhur gjithë gjërat që ekzistojnë në botën tonë. Bota e ideve është shkaku nga është krijuar bota jonë e sendeve konkrete. Bota e ideve është e përsosur/e përjetshme/ka qenie/është reale, bota jonë është mishërim i papërkryer/i mangët/kopje e shëmtuar e botës së ideve. Ekziston ideja e së mirës/së bukurës/së drejtës-. Prandaj bota jonë është degradim/rënie nga bota ideale/

Nxënësi fiton:

4 pikë Nëse shkruan katër momente nga teoria;

OSE

3 pikë Nëse shkruan tre momente nga teoria;

2 pikë Nëse shkruan dy momente nga teoria;

1 pikë Nëse shkruan një moment nga teoria;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12**3 pikë**

Përgjigje:

Abelardi shpalos parimin: “Nën shtysën e dyshimit ndërmerret kërkimi dhe, nëpërmjet kërkimit, ecet drejt njohjes së të vërtetës” Kjo formulë e përgjithshme me themel dyshimin është shtysë për çdo kërkim kritik. Dyshimi shihet si pikënisje në rrugën e kërkimit filozofik dhe teologjik. Ai është një dyshim metodik, që nënkupton një kontroll kritik të vazhdueshëm të teksteve filozofike të etërve të kishës, madje edhe të shkrimeve të shenjta. Si duhet analizuar një tekst për të triumfuar mbi dyshimin dhe për t’u afruar së vërtetës? Abelardi shprehet pro gjykimit të lirë edhe të veprave të Etërve të Kishës, të cilat nuk duhen lexuar me paramendim thjesht të të besuarit. Ai formulon disa kritere dhe rregulla për të vlerësuar e shmangur kontradiktat në pikëpamjet e teologëve.

Nxënësi fiton:

4 pikë Nëse shkruan katër momente nga parimi;**OSE****3 pikë** Nëse shkruan tre momente nga parimi;**2 pikë** Nëse shkruan dy momente nga parimi;**1 pikë** Nëse shkruan një moment nga parimi;**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.**Pyetja 13****2 pikë**

Shpjegoni konceptin e utopisë sipas Tomas Mor.

Model përgjigje:

U nis nga kritika e ashpër e kushteve ekonomike e shoqërore të Anglisë së kohës, për të dhënë modelin e imagjinuar të një bashkëjetesë ku sundon rendi dhe mirëqenia, që i lejon të gjithë të ndjekin dhe realizojnë lirisht interes të tyre. Ndër masat shpëtimprurëse bie në sy shfuqizimi i pronës private, ndërsa liria e besimit konsiderohet natyrshëm si shprehje e lirisë njerëzore.

Nxënësi fiton:

2 pikë Nëse shkruan dy aspekte nga koncepti;**OSE****1 pikë** Nëse shkruan një aspekt nga koncepti;**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.**Pyetja 14****3 pikë**

➤ Përgjigje e plotë:

Është tipik besimi te njeriu, besimi në arsye, pa këtë besim nuk ka forcë për t’u ngritur në mëngjes. Njeriu fillon të shihet si qendra e botës dhe dijeve për të. Përveç kësaj ai bëhet përcaktuesi i çdo kuptimi që ka për botën. Ky njeri nuk është si në rendin e vjetër-kuptimi dhe qëllimi i universit. Duke njohur e vëzhguar, ai merr pjesë në mrekullitë e botës tokësore, vlerëson të vërtetat empirike që i vijnë prej saj dhe përpiqet ta zbulojë atë gjatë gjithë jetës së tij. Kjo frymë (Galileo) është se njeriu i kohës moderne fillon të kërkojë të vërteta për të cilat ai bëhet gjithnjë e më i vetëdijshëm, se nuk mund t’i zotërojë përfundimisht, sepse ka shumë të tilla dhe se një e vërtetë ndryshon me kalimin e kohës. Njeriu modern është ekscentrik-i drejtuar gjithnjë e më tepër nga bota e jashtme.

➤ Përgjigje e pjesëshme:

- besimi te njeriu/ besimi në arsye/pa këtë besim nuk ka forcë për t’u ngritur në mëngjes. Njeriu fillon të shihet si qendra e botës dhe dijeve për të.
- njeriu bëhet përcaktuesi i çdo kuptimi që ka për botën./Ky njeri nuk është si në rendin e vjetër-kuptimi dhe qëllimi i universit.
- njeriu merr pjesë në mrekullitë e botës tokësore, vlerëson të vërtetat empirike që i vijnë prej saj dhe përpiqet ta zbulojë atë gjatë gjithë jetës së tij.
- njeriu i kohës moderne fillon të kërkojë të vërteta për të cilat ai bëhet gjithnjë e më i vetëdijshëm, se nuk mund t’i zotërojë përfundimisht, sepse ka shumë të tilla dhe se një e vërtetë ndryshon me kalimin e kohës. Njeriu modern është ekscentrik-i drejtuar gjithnjë e më tepër nga bota e jashtme.

Nxënësi fiton:

3 pikë Nëse shkruan tre momente nga mendimi filozofik;

OSE

2 pikë Nëse shkruan dy momente nga mendimi filozofik ;

1 pikë Nëse shkruan një moment nga parimi filozofik;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 15

3 pikë

Përgjigje:

- Filozofia mund të ishte një diskutim për botën(shkenca)
- Filozofia mund të ishte një diskutim për njohjen tonë mbi botën (metoda) vetëm duke qenë një diskutim metafizik/ domethënë një diskutim për Qenien e pafundme, të përkryer, Zotin, e cila përmban edhe botën, edhe njohjen tonë për botën.
- Në këtë përpjekje të mendimit ku metoda udhëheq metafizikën, e cila nga ana e vet është baza e metodës, çdo filozofi merrte formën e një sistemi absolut./ domethënë të një sistemi të përkryer dhe përfundimtar për shpjegimin e botës.

Nxënësi fiton:

3 pikë Nëse shkruan tre momente nga mendimi filozofik;

OSE

2 pikë Nëse shkruan dy momente nga mendimi filozofik ;

1 pikë Nëse shkruan një moment nga parimi filozofik;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 16

3 pikë

Përgjigje:

- Hegeli nuk i jep shumë rëndësi individit, por së tërës, shtetit në këtë marrëdhënie.
- Qytetari është pjesë e një të tërës, shtetit, dhe ashtu si një gjymtyrë nuk ka vlerë për trupin, edhe qytetari nuk ka vlerë pa shtetin.
- Megjithatë ai e mbështet të drejtën për pronën dhe veprimin e vullnetit të lirë të individit/ Në rast se shteti nuk harmonizon vullnetin e lirë, vullnetin e lirë individual me atë të përgjithshëm, atëherë do të kishim luftën e të gjithëve kundër njëri-tjetrit.
- Shteti është një sintezë e familjes dhe e shoqërisë qytetare.
- Duke marrë pjesë në jetën e shtetit, qytetarët fitojnë brenda tij ndërgjegjen e duhur të lirisë, pra nuk shkelin lirinë e njëri-tjetrit dhe bëjnë që arsyeja e shtetit të shndërrohet në një realitet.

Nxënësi fiton:

3 pikë Nëse shkruan tre elemente nga idetë e Hegelit;

OSE

2 pikë Nëse shkruan dy elemente nga idetë e Hegelit;

1 pikë Nëse shkruan një element nga idetë e Hegelit;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 17

3 pikë

Përgjigje:

Koncepti “Fe e njerëzimit” shihet prej Kontit jo në *rolin që ajo ka për individin*, por për shoqërinë dhe rendin e saj shoqëror. Në këtë pikë ai duket se *shkon kundër ndryshimeve që solli Revolucioni Francez*, ndryshime që *synuan ta kthejnë çështjen e fesë në një çështje private*. Meqë feja kishte garantuar një bashkësi interesash mbi bazën e moralit të saj, ajo *mund ta luante rishtazi këtë rol*, por pa dogmat që e shoqërojnë. Feja e njerëzimit, sipas Kontit, do të jetë *një fe pa zot*, dhe e vetmja gjë që do të *adhurohet e nderohet këtu janë ato qenie njerëzore që kanë ndikuar e do të ndikojnë në të ardhmen*, në rritjen e *mirëqenies së përbashkët njerëzore*. Konti rreshton shumë emra njerëzish që e kanë çuar përpara shoqërinë. Konti paraqitet si kryeprift, *dashuria është motiv drejtues* dhe parimi universal.

Nxënësi fiton:

3 pikë Nëse shkruan tre elemente nga thelbi i analizës;

OSE

2 pikë Nëse shkruan dy elemente nga thelbi i analizës;

1 pikë Nëse shkruan një element nga thelbi i analizës;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 18**3 pikë**

- Njeriu drejtohet nga nevoja të tilla si bukuria / kënaqësia,
- Njeriu përpiqet të shfrytëzojë të gjitha burimet e kënaqësisë që i jep jeta.
- Këtu njeriu nuk ndihet shumë i përgjegjshëm për zgjedhjet e tij / liria është e plotë/njeriu është i gatshëm t'i shkelë rregullat morale për hir të kënaqësive.

Nxënësi fiton:

3 pikë Nëse shkruan tre tipare;**OSE****2 pikë** Nëse shkruan dy tipare;**1 pikë** Nëse shkruan një tipare;**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.**Pyetja 19****3 pikë**

- Është një nga dy rrugët kryesore për të njohur jetën.
- Kur përdoret nga shkenca, na ofron një njohje të jashtme dhe i ndan gjërat.
- Kur studiojmë diçka shkencërisht, objekti ynë i njohjes copëzohet dhe gjërat e lidhura shihen të veçuara e të ndara./ P.sh., kur studiojmë qelizat e një bime, ne shkëpusim një gjethe prej saj për ta vënë në mikroskop.

Nxënësi fiton:

3 pikë Nëse shkruan tre tipare;**OSE****2 pikë** Nëse shkruan dy tipare;**1 pikë** Nëse shkruan një tipar;**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.**Pyetja 20****3 pikë**

- Disa e quajnë Niçen nihilist, sepse ai duket se mohon tërësisht vlerat e trashëguara në fushën e moralit/fesë / filozofisë.
- është një nihilist që edhe pohon.
- propozon një moral me vlera ku të respektohet individi dhe jo vetëm grupi. (Vlerat duhet të ndihmojnë që njeriu të arrijë shkallën më të lartë të zhvillimit të tij si genie dhe jo ta gjymtojë atë
- Bota është për ne ajo që na jepet nga një mori traditash: morale/fetare /artistike.
- Me këto ndikime në kokën tonë ne shohim botën. Kjo është ideja e Niçes në punimin “Përtej së mirës dhe së keqes.”
- Sipas tij, nuk ka vlera absolute për t'u zbuluar.
- Vlera janë forma me anën e të cilave njeriu kap të vërtetën historike.
- Prandaj herë pas here njerëzit janë të detyruar t'i rishikojnë vlerat. Këtë ndryshim të vlerave e tregon edhe morali. (Nëse në antikitet virtyt quhej trimëria dhe burrëria, sot gjërat kanë ndryshuar dhe virtyt mund të quhet dija, fama, etj.)
- Shoqëria është vazhdimisht në kërkim të vlerave të vërteta, mendon Niçja.
- Vlerat e vjetra zhvlerësohen kur ato nuk mund të japin më përgjigje për dukuritë shoqërore dhe nuk ofrojnë më qëllime për t'u arritur..

Nxënësi fiton:

3 pikë Nëse shkruan saktë të tria përgjigjet e kërkesave**OSE****2 pikë** Nëse shkruan saktë dy nga përgjigjet e kërkesave**1 pikë** Nëse shkruan një nga përgjigjet e kërkesave;**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.